



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.3.2022, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vijimi dhe mbyllja e diskutimit nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Ina Zhupa, Eralda Bano Tase, Merita Bakiu, Kastriot Piroli dhe Lavdërim Krashi(zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Aça, Lindita Buxheli, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

Të ftuar:

Meri Kumbe – Zëvendësministre e Kulturës,

Borana Ajazi – drejtore e Drejtorisë së të Drejtës së Autorit.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Sot në rendin e ditës kemi vetëm një çështje, që është një çështje shumë e rëndësishme. Vijn diskutimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Ne jemi në funksion të komisionit përgjegjës.

Relatore është zonja Enslemvera Zake.

Të ftuar kemi zëvendësministren e kulturës, zonjën Meri Kumbe.

Mirë se erdhët, zonja Zëvendësministre!

Kemi të ftuar, gjithashtu, zonjën Borana Ajazi, drejtore e Drejtorisë të së Drejtës së Autorit.

Mirë se erdhët, zonja drejtoreshë!

Fillojmë mbledhjen duke ju komunikuar, së pari, se si ministria, ashtu edhe stafi i komisionit, por edhe një pjesë e kolegëve kanë bërë një punë aktive, ndërkohë që ne jemi marrë edhe me çështje të tjera që ka pasur rendi i ditës së këtij komisioni dhe besoj se kemi ardhur me një zgjidhje në përgjithësi konsensuale. Janë marrë parasysh të gjitha propozimet racionale, edhe të palëve të interesuara, sidomos të Shoqatës së Botuesve Shqiptarë që, me sa duket, ka pasur propozime, të cilat ishin racionale dhe janë integruar tashmë në projektligj.

Siç e dini, ne kemi bërë votimin në parim, pastaj kemi votuar edhe nenin 1. Aty e kemi lënë për të vijuar diskutimin më tej për të ardhur në një situatë më konsensuale lidhur me përmbajtjen e projektligjit, meqenëse nuk është një ligj i natyrës politike, përgjithësisht me përmbajtje teknike.

Ndërkohë, do të vazhdojmë, kështu që, kur të kalojmë në shqyrtimin e nenit, do të na duhet një diskutim nga ju, zonja Zëvendësministre, apo nga drejtoresha për të na sqaruar, sepse një pjesë e kolegëve nuk janë marrë fjalë për fjalë me projektligjin, ndërkohë që edhe nenet janë shumë të gjata.

Kalojmë te neni 2.

Përpara se ta hedhim në votim, ju lutem, zonja Zëvendësministre, një sqarim!

Meri Kumbe – Mirë se ju gjetëm!

Lidhur me nenin 2, theksoj se ne i kemi parë me shumë përgjegjësi dhe me shumë imtësi të gjitha propozimet që kanë ardhur nga grupet e interesit.

Lidhur me veprat pa autor, përgjithësisht, propozimet e tyre lidhur me kërkimin shterues janë propozime që shkojnë në kundërshtim me direktivat e BE-së. Pra, kërkimi i veprës pa autor është kompetencë e institucioneve.

Pa dyshim, kemi pranuar disa prej komenteve të ardhura nga Shoqata e Botuesve lidhur me shtimin në databazë edhe të Shoqatës së Botuesve, por nuk mund të kemi prekje të formulimeve, sikurse pretendohet.

Nëse më lejoni, kryetar, do të doja që për më shumë teknikalitete t'ia kaloja fjalën drejtoreshës, e cila ka punuar edhe në detaje.

Faleminderit!

Petro Koçi – Zonja Borana, fjala për ju.

Borana Ajazi – Faleminderit!

Neni 2, pikat 16/1, 16/2 dhe 16/3 përcaktojnë, së pari, statusin, pra çfarë janë veprat pa autor, cilat janë subjektet që bëjnë kërkimin për të përcaktuar nëse një vepër është pa autor apo jo, pra duhet të marrë statusin “vepër pa autor” apo jo, në cilat fusha do ta bëjë kërkimin, cilat janë këto burime, ku këto institucione kulturore do të drejtohen për të bërë kërkimin për t'i dhënë statusin “vepër pa autor”.

Së fundi, është edhe kompensimi i veprave pa autor. Në qoftë se një vepër, e cila e ka këtë status, në një moment të caktuar, individi që e ka krijuar këtë vepër, vendos t'i japë fund statusit, në këtë moment institucioni, i cili ka përdorur veprën pa autor gjatë gjithë kohës kur ka pasur këtë status, është i detyruar të bëjë shpërblimin e përdorimit të veprës; në qoftë se ka pasur përfitime financiare, sepse ka edhe momente që përdorimi nuk është për interesa financiare, siç është pjesa më e madhe e direktivës.

Këto tri shtesa të pikës 16 kanë të bëjnë vetëm me këto tri pika kryesore.

Siç tha edhe zëvendësministrja, ka pasur propozime nga Shoqata e Shtëpive Botuese dhe jemi dakord, sipas materialit që kemi përpara, që te burimet shteruese të shtohet një nga burimet, që ato e kanë të nevojshme, në lidhje me kërkimin; dhe ky është specifikisht për katalogët editorialë të shtëpive botuese.

Jemi shumë dakord se ky është një vlerësim që qëndron dhe institucionet duhet ta kenë parasysh, para se të japin statusin e një vepre pa autor.

Ndërkohë, ka një pretendim tjetër, është pretendimi për përgjegjësinë që duhet të marrë secili kërkues, pjesë e këtyre institucioneve, për të dhënë statusin e veprave pa autor. E gjithë fryma e direktivës është që institucioni, i cili e përdor, gjithashtu mbart edhe detyrimin për të mbajtur, nuk them ligjor, por një farë detyrimi për kryerjen me kompetencë të këtij kërkimi.

Pse nuk mund të pranohet propozimi i shtëpive botuese? Sepse, në qoftë se një punonjës i thjeshtë i një institucioni, që mund të jetë një bibliotekë, një librari apo një institucion tjetër kulturor, kur bën kërkimin dhe i jep statusin “vepër pa autor” ajo do të botohet, gjithashtu, në bazën e të dhënave, pra automatikisht vlerësohet që kërkimi është bërë nga fillimi deri në fund dhe për këtë arsye është dhënë statusi dhe është botuar si vepër pa autor. Pra, nuk mund të kenë më shumë përgjegjësi se sa kaq. Mban përgjegjësi në kryerjen e funksionit të tij, gjithashtu, e pasqyrojmë edhe në bazën e të dhënave dhe nuk është e nevojshme të shënohet në ligj një dispozitë e natyrës “të mbahet përgjegjësi”, se nuk është as fryma e direktivës, kështu që është e panevojshme, në lidhje me pikën 16.

Petro Koçi – Faleminderit!

A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët?

Urdhëroni, zonja Zhupa!

Ina Zhupa – Ne kemi pasur mundësi që edhe të takoheshim paraprakisht. Për sa i përket nenit 2, vë re se janë marrë parasysh elementet e katalogëve editorialë dhe të librave në qarkullim. Për sa i përket sqarimit që dha drejtoresha, te pjesa e përgjegjësisë, ne mendojmë se mund t’i qëndrojmë direktivës, kështu që për nenin 2 ne jemi në parim dakord.

Petro Koçi – Kush është dakord me nenin 2? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, i cili prek nenin 75 të ligjit në fuqi.

Urdhëroni!

Borana Ajazi – Neni 75 është gjithmonë në frymën e direktivës. Jemi në të njëjtën fushë, direktiva e veprave pa autor.

Sigurisht, përdorimi i veprave pa autor, si çdo vepër tjetër që është në fushën e së drejtës së autorit, nuk mund të përdoret për përfitime ekonomike. Ky është parimi kryesor i ligjit. Pra, çdo përdorim ekonomik i një vepre pa autor duhet të ketë një autorizim. Ky nen pikërisht u adresohet kufizimeve nga institucione të veçanta të kësaj kategorie, që do të merren gjithmonë me veprat pa autor, gjithmonë me përfitime joekonomike, pra është në rrjedhim të interpretimit të direktivës dhe të neneve të direktivës.

Petro Koçi – Ky është nen që mbron konsumatorin.

Kush është dakord me nenin 3? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4, i cili u referohet neneve 75/1 dhe 75/2 të ligjit në fuqi.

Borana Ajazi – Neni 75/1 është përdorimi pa kufizim i veprave pa autor. Siç e thashë, duhet një autorizim për ta përdorur të drejtën e autorit. Ka raste, të cilat janë shprehimisht të caktuara në ligj, në të cilat mund të përdoret një vepër për qëllime të caktuara. Këto janë, sigurisht, qëllime edukimi, ose siç jemi në rastin e direktivës së veprave pa autor dhe institucionet, që do të përdorin një vepër pa autor, do ta bëjnë me qëllim digjitalizimin, pra këto vepra pa autor do të vihen në dispozicion të publikut, pa asnjë përfitim ekonomik.

Ajo që unë do të doja të ndalesha, është pjesa tjetër, që është kompensimi i përdorimit të veprave pa autor. Në momentin që jepet statusi “vepër pa autor”, autori mund të ekzistojë ose jo, mund të ketë shumë kohë që ka ndërruar jetë e kështu me radhë, por në momentin që ai do të vendosë t’i japë fund të këtij statusi, sepse e drejta e autorit është vetëm e individit që e mban, ai ka të drejtën ta fillojë, ta mbarojë, ta tjetërsojë, ta ndryshojë e kështu me radhë, ka të drejtën e një kompensimi të drejtë. Nuk e them pa qëllim “kompensim të drejtë”, sepse kompensimi i të drejtës së autorit ka një metodologji, ka një mënyrë se si shpërblehet çdo përdorim. Kompensimi i veprave pa autor nuk mund të jetë i njëjtë:

E para, mënyra për të cilën është përdorur.

E dyta, hapësira kohore në të cilën është përdorur dhe, nëse do të përdorim të njëjtat tarifa shpërblimi të së drejtës të një veprave pa autor, siç përdoret një vepër me status “vepër me autor”, do të kishte një amulli të jashtëzakonshme.

Pra, direktiva përcakton që kompensimi do të jetë i drejtë me mënyrën e përdorimit. Ky është neni 75/2. Mënyra se si do të bëhet kompensimi, procedura, cilat janë institucionet përkatëse, do të rregullohen me akt ligjor, të cilin do ta shihni më poshtë.

Petro Koçi – Pra, shpërblehet në përputhje me mënyrën e përdorimit, duke pasur parasysh kohën.

Borana Ajazi – Vetëm në qoftë se ka pasur shpërblime financiare.

Petro Koçi – Nëse është përdorur si vepër pa autor, por nuk ka pasur përfitime financiare, nuk kompensohet.

Kush është dakord me nenin 4? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5, i cili u referohet pikave 1 dhe 2 të nenit 77 të ligjit në fuqi.

Borana Ajazi – Këtu hyjmë te direktiva tjetër, e cila është përafuar nga projektligji, pra direktiva e përdorimit të veprave pa autor nga persona me aftësi të kufizuara në shikim.

Ligji është i saktë, është i qartë në lidhje me përdorimin e veprave nga kjo kategori, megjithatë, në bazë të direktivës, e cila është ndryshimi i direktivës së parë, të cilin ne e kemi

të përafuar plotësisht, ligji e ka të përafuar plotësisht, ka disa ndryshime në terminologji dhe në mënyrën se si kujdestari ligjor i një personi me aftësi të kufizuar në shikim mund të marrë me autorizim përdorimin e një vepre nga individi i kësaj kategorie, me qëllimin e vetëm për përdorim personal. Në qoftë se unë jam kujdestari ligjor i një personi me aftësi të kufizuar në shikim, mund ta marr në përdorim një vetëm pa autor, por vetëm për qëllime të përdorimit personal të personit tjetër. Më lejoni t'ua them thjesht fare! Një person me aftësi të kufizuar mund të marrë një libër në bibliotekë, mund të bëjë fotokopje ose përshtatje të këtij libri në formën e të lexuarit “*Brail*” për përdorim personal. Pra, ky është i gjithë qëllimi.

Petro Koçi – Është në përputhje edhe me Kodin Civil, më thonë.

Kush është dakord me nenin 5? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6, i cili është shtim neni. Pas nenit 77, shtohet neni 77/1 dhe 77/2 me përmbajtjen respektive që sërish lidhet me këtë kategori, që sapo përmendëm.

Ju lutem, një sqarim!

Borana Ajazi – Përkufizime të mëtejshme, detaje të mëtejshme në lidhje me kategorinë e personave që do të quhen “persona me aftësi të kufizuar në shikim” dhe kujdestarët e tyre, direktiva këtë ka bërë, pra ka specifikuar më mirë, ka dhënë detaje më të sakta në lidhje me këtë kategori.

Petro Koçi – Kush është dakord me nenin 6? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7.

Ju lutem, një sqarim!

Meri Kumbe – Faleminderit!

Këtu jemi te propozimet që kanë ardhur në lidhje me prezumimin, të cilat ne i kemi marrë parasysh dhe i kemi reflektuar në pjesën më të madhe të tyre, për më shumë teknikalitete dhe shpjegime teknike, me lejen tuaj po ia kaloj fjalën drejtoreshës.

Borana Ajazi – Në vijim të diskutimeve që kemi bërë më parë, prezumimi, që është përfaqësimi i të gjithë mbajtësve të të drejtave të së njëjtës kategori, qofshin ata anëtarë apo jo anëtarë, shqiptarë apo të huaj, është i parashikuar në ligjin ekzistues, në nenin 135.

Ndërkohë, më lejoni vetëm një sqarim të vogël. Neni 131 i ligjit ekzistues përcakton administrimin kolektiv të detyrueshëm, që do të thotë mbledhje e të ardhurave dhe përfaqësim vetëm përmes agjencive të licencuara. Për këtë arsye, prezumimi, i cili qëndron, i riformuluar

dhe i bërë më i qartë për mënyrën se si do të funksionojë, është paraqitur në pikën 3 dhe 4 të nenit ekzistues 131. Kjo me qëllim që i gjithë interpretimi të shkojë te logjika ligjore e administrimit kolektiv të detyrueshëm dhe prezumimit.

Për këtë arsye, ai nuk është më pjesë e pikës 1 të nenit 135, por janë pikat 3 dhe 4 të nenit 131. Megjithatë, do të doja ta lexoja për ju: “Për të drejtat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni” – thotë projektligji “agjencitë e administrimit kolektiv kanë kompetencat e përfaqësimit të të gjithë mbajtësve të të drejtave, anëtarë e jo anëtarë, vendës e të huaj për të drejtat respektive”. Pra, koncepti i prezumimit.

Petro Koçi – Siç e mbani mend, kjo ka qenë një nga çështjet më të diskutuara, dhe ne si komision e dhamë mendimin paraprak, që të ruhej e drejta e prezumimit të përfitimit edhe nga ata që janë jo anëtarë të AAK-ve, pra të agjencive të administrimit kolektiv. Ndërkohë, ne kërkuam që edhe kjo të kushtëzohej, domethënë të mos ishte një e drejtë e abuzueshme, arsye për të cilën është vendosur pika tjetër: “Mosrespektimi dispozitave ligjore, të cilat lidhen me administrimin kolektiv të detyrueshëm përbën kusht për heqjen e licencës.”

Atëherë, kush është dakord me nenin 7, sipas përmbajtjes së ndryshuar? Faleminderit!

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Faleminderit!

Miratohet edhe neni 7.

Kalojmë te neni 8, që bën fjalë për pikën 2 të nenit 135 të ligjit në fuqi.

Borana Ajazi – Më lejoni të them se pika 3 e nenit 131 ishte e parashikuar në pikën 2 të nenit 135. Për rrjedhojë, nga ana e teknikës legjislative, pika 2 është e ndryshuar vetëm me të drejtën e mbajtjes së të drejtave për t’u larguar nga agjencia e administrimit. Pra, është thjesht teknikë legjislative.

Petro Koçi – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 8, sipas përmbajtjes?

Faleminderit!

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 8 miratohet!

Kalojmë te neni 9, i cili i referohet nenit 138 të ligjit në fuqi, që është: Sporteli unik.

Borana Ajazi – Sporteli unik. Ndryshimet në lidhje me nenin 138 konsistojnë së pari në krijimin e formës juridike të këtij sporteli. Neni aktual 138 nuk e ka formën ligjore të funksionimit të kësaj strukture të veçantë, kështu që në mënyrë të vazhdueshme përcaktohet

forma ligjore, përcaktohet krijimi i strukturës, mënyra se si ajo do të funksionojë, pra bordi i saj, përcaktimi i drejtorit ekzekutiv. Nuk është e ndryshuar ndarja e përqindjeve. Do të vazhdojnë të jenë njësoj si në ligjin aktual: 40-30-30 për kategori të caktuara.

Megjithatë, për interesin tuaj, ka diçka: në pikën 8, germa 'a', që është

40-përqindëshi i shpërndarjes së të ardhurave për të drejtën e autorit, mund të ndodhë siç është në situatën aktuale, që ka dy agjenci të licencuara për të drejtën e autorit: është agjencia Albautor për muzikën, për krijimet e muzikës, me apo pa tekst; është edhe agjencia FMA për prodhimet audiovizuale. Të dyja janë me të drejtë autori.

Në eksperiencën e kaluar ka ndodhur që 40-përqindëshi i shpërndarë nga SUADA ka hasur në problematika të shpërndarjes midis dy agjencive. Për këtë arsye, është e nevojshme që të ketë një përqindje të caktuar, një metodologji të caktuar të shpërndarjes së 40-përqindëshit midis agjencive ekzistuese dhe atyre që mund të krijohen në të ardhmen, sepse e drejta e autorit ka shumë nënkategori. Pra, nuk është vetëm muzika dhe audiovizualja, por janë edhe vallet, është piktura, është fotografia e kështu me radhë. Janë shumë nënkategori. Në të njëjtën situatë ku jemi tani, do të ndodhemi edhe në të ardhmen, mbase me licencimin e një agjencie tjetër. Për këtë arsye, është vendosur që Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit, një strukturë e cila është zhblllokuese. Në rastet kur ka mosarritje të marrëveshjeve nga agjencitë e administrimit kolektiv, ndërhyjnë KKDA-ja; ato të përcaktojnë ndarjen e përqindjes në bashkëpunim me agjencitë e administrimit kolektiv në lidhje me 40-përqindëshin, që është i vetmi element përcaktues.

Gjithashtu, nëse i mbani mend diskutimet tona të gjata...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pika 9, po.

Diskutime të gjata ka pasur me agjencitë edhe në lidhje me drejtorin ekzekutiv të sportelit unik. Drejtori ekzekutiv është një strukturë e pavarur, duhet të jetë absolutisht i pavarur nga agjencitë e administrimit kolektiv, nuk mund të vijë nga radhët e tyre. Ai do të merret me ekzekutimin nga ana administrative të të gjithë vendimeve ekskluzive të bordit, i përbërë nga agjencitë e administrimit kolektiv. Këtë do ta vendosin vetë agjencitë. Në rast se nuk ka një marrëveshje, e cila do të bllokonte ekzekutimin e vendimeve të bordit, do të ndërhyjë Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit. Njëlloj siç ndodh tani në lidhje me drejtimin e sportelit unik SUADA, gjë që në projektligj përbën risi. Pra, nuk mund të ketë më një agjenci drejtuese. Është bordi që vendos, është drejtori ekzekutiv që ekzekuton vendimet. Kaq.

Petro Koçi – E qartë! Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 9, sipas formulimit në projektligj?

Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 10, i cili i referohet nenit 157 të ligjit në fuqi.

Borana Ajazi – Pika 1 e nenit 10 është teknikë legjislative. Me futjen e direktivës, në lidhje me veprat pa autor, me amendimin e saj në ligj, është e nevojshme të bëhen ndryshime në terminologjinë, që është “veprat pa autor”. Ndërsa në pikën 2, Drejtoria e të Drejtës së Autorit administron një regjistër manual. Ky regjistër do të bëhet elektronik. Veprat pa autor do të jenë pjesë e këtij regjistri elektronik. Pra, neni 10 është teknikë legjislative, dhe përfshirja e këtyre veprave në këtë regjistër elektronik që do të krijohet, i cili do të përmbajë të gjitha veprat ekzistuese, përfshirë edhe veprat pa autor.

Petro Koçi – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 10, sipas formulimit?

Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Vijojmë me nenin 11: pika 5 e nenit 159 ndryshohet.

Borana.

Borana Ajazi – Neni ekzistues i ligjit përcakton: “Në qoftë se Drejtoria e të Drejtës së Autorit, pasi bën monitorimin e veprimtarisë së agjencive të administrimit kolektiv, konfirmon se ka shkelje të ligjit, u jep atyre 30 ditë kohë për të rregulluar të metat, dhe në rast të mosrregullimit të të metave kalohet në një procedurë administrative të thjeshtë.”

Këto 30 ditë kohë janë perceptuar si një afat i panevojshëm. Në qoftë se do të ketë shkelje të ligjit të së drejtës së autorit, agjencitë, si çdo subjekt tjetër, janë të detyruara të zbatojnë ligjin. Prandaj, ne nuk e shohim të nevojshme të ketë procedurë mbi procedurë. Mjafton të zbatohet një procedurë administrative. Sipas Kodit të Procedurave Administrative bëhet njoftimi i palëve, mbledhja e informacioneve, dëgjimi i tyre, deri në marrjen e një vendimi. Pra, janë kohë të mbivendosura e të panevojshme.

Petro Koçi – Vetëm një gjë na sqaro: çfarë ndryshon?

Borana Ajazi – Hiqet afati 30-ditor.

Petro Koçi – Ah, hiqet? Në rregull!

Borana Ajazi – Po.

Pra, në rast se DDA-ja, Drejtoria e të Drejtës së Autorit konstaton se veprimtaria nuk është në përputhje me dispozitat, i propozon ministrit për të drejtat e autorit fillimin e

procedurave të pezullimit për tre vjet dhe aktet e sipërpërmendura hyjnë në fuqi. Pra, hiqet afati 30-ditor. Procedura është e shpjeguar më sipër.

Petro Koçi – Po, e qartë!

Zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Nga agjencitë ka ardhur një propozim i arsyeshëm, ndaj nuk e kuptoj pse s’duhet të pranohet, për sa kohë që riformulimi është i tillë, që kërkojnë agjencitë, gjë që pastaj do t’jua shpjegoj. Aktet e sipërpërmendura hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, në rast se nuk është ushtruar ankim në gjykatën kompetente, për kundërshtim të këtij akti administrativ.

Tani, pse ju mendoni se ne nuk duhet ta përfshijmë një të drejtë që ka çdo subjekt për të shkuar në gjykatë, për të ankimuar dhe për të pritur vendimin e saj? Ne jemi shtet ligjor, ndaj duhet të respektojmë të gjitha hallkat, dhe gjykata është një nga hallkat e shtetit të së drejtës. Kësisoj, për mendimin tim, duke u nisur edhe nga arsyetimi i agjencive, nuk ka arsye që ta heqim këtë dhe të mos e përfshijmë në ligj, si një e drejtë kushtetuese e çdo subjekti për t’u ankimuar në gjykatë, në rast se mendon që një akt administrativ nuk është i drejtë. Ne duhet të presim vendimin e gjykatës, sepse problemi në Shqipëri, jo vetëm në këtë rast, por në përgjithësi, është se bëhen fakte të kryera pa pritur vendimet e gjykatës. Më pas, kur gjykata merr një vendim, i cili është i ndryshëm nga akti fillestar, që është marrë, nuk ke më mundësi as ta ekzekutosh. Këtu më vjen ndërmend Teatri Kombëtar: kur gjykata thotë se është jokushtetuese, nuk kemi më teatër, sepse s’kemi si ta ekzekutojmë. Kështu, edhe në rastin tuaj, gjykata duhet të jetë e përfshirë, sepse në rastin kur është ankimuar një akt administrativ, cilido qoftë ai, dhe më pas gjykata vendos që, po, kanë pasur të drejtë në këtë ankimim, ti e ke botuar në Fletoren Zyrtare, ke mbaruar procesin, për rrjedhojë është shumë e vështirë t’i rikthehesh, sepse ndërkohë ka marrë kompetenca ligjore, akti, pagesa apo cilidoqoftë problematika.

Prandaj, kjo ideja që keni ju, për ta shmangur gjykatën, për mua nuk qëndron, sepse jemi një shtet i së drejtës, në të cilin gjykatat nuk janë për t’u shmangur, por janë për t’u vlerësuar si një pushtet tjetër, që na kontrollon të gjitha palëve dhe qëndron përmbi palët, pavarësisht të gjitha problemeve që ne mund të kemi me gjyqësorin. Prandaj, ne jemi kundër këtij neni të pandryshuar, të cilin ju ftojme ta ndryshoni, duke reflektuar frymën që ka një shtet ligjor.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Zhupa!

Nuk e di nëse kjo përfshihet në nen, por a e ndalon dot zbatimin e procedurës së të drejtës administrative?

Borana Ajazi – Në qoftë se mundem, akti i pezullimit apo i heqjes së licencës është si çdo akt tjetër administrativ. Të drejtën e ankimit në gjykatë nuk e ndalon. Ama, nuk është e mundur që një proces gjyqësor... Pra, është një akt administrativ, siç është akti administrativ i dhënies së licencës për agjencitë e administrimit kolektiv. Në qoftë se ne do të prisnim shqyrtimin nga gjykata të proceseve gjyqësore, të cilat tek Drejtoria e të Drejtës së Autorit kanë zgjatur edhe tre vjet, kjo do të thotë se ne nuk mund të zbatojmë të drejtën e autorit dhe agjencitë nuk mund të funksionojnë.

Po kështu, në qoftë se një agjenci është konstatuar në shkelje, pasi i janë dhënë të gjitha të drejtat për të sjellë dokumentet plotësuese për t'i dhënë të drejtën për t'u dëgjuar me një procedurë administrative të thjeshtë, nuk i mohohet e drejta e gjykatës. Ajo vijon, por është dhënia e një mase për pezullimin apo heqjen e licencës. Ndërkohë, mund të jetë një agjenci tjetër, e cila mund të aplikojë dhe të licencohet dhe menaxhimi kolektiv mund të vazhdojë, por nuk mund të kufizohemi nga gjykata, që është një procedurë e pavarur nga akti administrativ.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë!

Zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Patjetër që do të kufizohesh. Është brenda ligjeve e rregullave. Sepse, shiko çfarë bën: po marr rastin që ju, institucioni juaj ka gjykuar gabim dhe i ka hequr të drejtën një agjencie apo ka pezulluar një agjenci, por ndërkohë çështja vazhdon në gjykatë. Duke i hequr të drejtën, ti automatikisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi? Mirë pra, po të mbaroj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që do të presësh gjyqin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lejoni ta shpjegoj!

Agjencitë që e kërkojnë këtë janë ato që shpërndajnë paratë tek autori. Apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në momentin që ti e pezullon agjencinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kapet në shkelje. Kush i çon paratë te autori, kur ti e ke pezulluar agjencinë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht! Pra, ti i ke hequr mundësinë kësaj agjencie, që të vazhdojë veprimtarinë e saj për të korrigjuar edhe një gabim që mund të ketë bërë e të tjera e të tjera. Por në fund është

gjkata ajo që vendos nëse është bërë apo jo ky gabim. Është shumë e thjeshtë: në çdo veprim që bëjmë në këtë shtet, kemi dhe duhet të kemi mundësinë të shkojmë në gjykatë dhe të ankimojmë, se nuk ekzekutohet veprimi pa marrë vendimin e gjykatës. Është baza e shtetit ligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po kështu është. Kështu duhet të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sepse, kur këta e kanë ankimuar në Gjykatën Administrative dhe janë duke pritur një vendim, fakti që ne nuk e presim këtë vendim të gjykatës dhe vazhdojmë të gjitha hallkat, bën që vendimi i gjykatës të rezultojë i kotë, sepse gjithçka është kryer dhe ka tre vjet që është mbyllur kjo çështje. Unë ju solla shembullin e Teatrit Kombëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është e njëjta gjë, por ata që thonë se prishja është jokushtetuese, por sot nuk kemi teatër. Prapë ministria juaj është.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj duhet pritur gjykata.

Petro Koçi - Faleminderit, zonja Zhupa!

Edhe një herë, që ta kemi të qartë, e drejta e shfrytëzimit të procedurës administrative, që do të thotë edhe mundësi për të shfrytëzuar gjykatën, nuk pengohet nga përmbajtja e nenit. Në asnjë nen tjetër të ligjeve të tjera, pavarësisht se çdo palë, në një konflikt, për një licencë, për një të drejtë, kur i pezullohet nga autoriteti kompetent, nuk shkruhet që autoriteti duhet të presë vendimin e gjykatës. Kjo është një e drejtë automatike, prandaj them të mos e ngatërrojmë.

Ke të drejtë që shqetësohesh për shfrytëzimin e gjykatës, por kjo ndodh automatikisht. Pra, në momentin që autoriteti kompetent, që në këtë rast është ministri, jep një pezullim, atëherë i pezulluari ka të drejtë ta çojë në gjykatë, si çdo i pezulluar tjetër, jo në kulturë, por ku të duash, në polici e lloj-lloj të drejtash. Pra, nuk e pengon kjo përmbajtje. Nuk kemi në asnjë nen tjetër të ligjeve të tjera të tillë përmbajtje, pra, që autoriteti kompetent të presë vendimin e gjykatës. Kjo është një gjë që ndodh automatikisht. Pra, dikush e shfrytëzon të drejtën për t'u ankuar në gjykatë dhe natyrisht pret vendimin e gjykatës, por nuk pezullohet procesi ligjor i administrimit të gjërave.

Kështu që, unë mendoj se nuk është rasti për të bërë debat.

Edhe një herë, zonja zëvendësministre.

Meri Kumbe – Faleminderit!

Doja të shtoja diçka për sa thatë ju. E njëjta e drejtë i lind edhe një subjekti që nuk licencohet, por kjo nuk do të thotë ...

Pra, nëse një aplikant kërkon të marrë një licencë për të ushtruar aktivitetin dhe institucioni nuk ia jep, sepse nuk përmbush kriteret e parashikuara në ligj, po në të njëjtën logjikë, subjekti ka të drejtë të ankimojë në gjykatë vendimin e organeve kompetente. Kjo nuk do të thotë se agjencitë e tjera të licencuara nuk do të vazhdojnë punën. Është e njëjta logjikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është identike e njëjta logjikë. Ju ngritët problemin e kontestimit të një vendimi administrativ. Cilido qoftë ky vendim, qoftë për licencim, qoftë për ekzekutim të drejtash, e para, për të arritur deri në licencim ose heqjen e licencës ka një sërë masash që parashikohen në ligj. Pra, nuk është një vendim i marrë nga një individ i vetëm, por ka një procedurë që e mirëpërcakton dhe është komplet transparente dhe në përputhje me të gjitha legjislativet e tjera që lidhen pikërisht me të drejtat administrative.

Kështu që, në këtë këndvështrim është e njëjta gjë. Pra, hedhja në gjyq e një vendimi administrativ në asnjë rast nuk duhet të pengojë funksionimin e organeve të tjera. Për sa i përket çfarë ndodh në atë rast, vazhdojnë mbledhjen të drejtat dhe është SUADA, pra Sporteli Unik, i cili merr më tej të drejtën për t'i shpërndarë. Sigurisht, ka një procedurë të komplikuar, nuk është aq e thjeshtë, por nuk mbivendosen. Nuk besoj se asnjëri nga ne do të ishte dakord të shkonim në kurriz të qytetarëve. Gjykata ka afatet e saj dhe në fuqi të shtetit demokratik ka fjalën dhe shprehet, por në asnjë rast nuk mundet njëra të bllokojë tjetrën.

Faleminderit!

Petro Koçi - Unë e mirëkuptoj shqetësimin e zonjës Zhupa dhe shqetësimin e AAK-ve, por ligji që po shqyrtojmë ne mbron të drejtat e autorit, jo automatikisht agjencitë. Pra, thelbi i ligjit është mbrojtja e të drejtës së autorit. Pra, në momentin që agjencia e rrezikon të drejtën e autorit, ndërhyhet. Nuk e bllokun dot ky nen dhe as çdolloj neni tjetër i ligjeve tona të drejtën e shfrytëzimit të gjykatës për një çështje që ka diskutim.

Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

Po, Borana.

Borana Ajazi - Neni 12 përcakton kushtet për pezullimin dhe heqjen e licencës së agjencive të administrimit kolektiv. Nga Ministria e Drejtësisë, gjatë kohës së konsultimit të projektligjit, është kërkuar nga ministria që këto kushte, të cilat janë të përcaktuara në një akt nënligjor me udhëzim të ministres së Kulturës, të jenë të përcaktuara edhe në ligj. Ky nen është

krejtësisht i ri vetëm për ta pasqyruar për sa i përket teknikës legjislative dhe kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për të qenë pjesë e ligjit. I vetmi ndryshim që ka nga udhëzimi, i cili do të bëjë edhe ndryshimet përkatëse me hyrjen në fuqi të ligjit, është germa “d” e pikës 2, mosrespektimi i dispozitave ligjore, të cilat lidhen me administrimin kolektiv të detyrueshëm. Siç e thamë, administrimi kolektiv i detyrueshëm, siç u dha mundësia për të pasur këtë mënyrë administrimi, sigurisht do të ketë edhe kufizime. Mosrespektimi i dispozitave në lidhje me mbledhjen, shpërndarjen, zbatimin e detyrimeve për shpërndarje tek autorët, sipas kontratave e të tjera, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj, është e vetmja shtesë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E drejtë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Nëse e mbani mend, kjo ka qenë një nga pikat ku agjencitë kanë pasur argumente. Sugjeroj, dhe do ndoshta do të ishte pranuar, që në nenin 12, ku ne jemi, pika 2, germa “a”, të bëhet një riformulim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 12, pika 2, heqja e licencës.

Formulimin e germës “a”, “kur konstatohet shkelje e kuadrit ligjor për të drejtën e autorit lidhur me shpenzimet dhe shpërndarjen e shpërblimeve”, po e lexoj të riformuluar, që ju ta dëgjoni si është sugjerimi dhe do t’ju jap edhe argumentimin: “kur konstatohet shkelje e kuadrit ligjor për të drejtat e autorit lidhur me shpenzimet dhe shpërndarjet e shpërblimeve, përjashtimisht në shpenzimet e domosdoshme minimale të AAK-së, në përputhje me kushtet dhe kriteret e tyre për licencim, të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Kulturës”. Çfarë do të thotë kjo?

Në rastin e pandemisë, besoj se ju jeni në dijeni të këtij fakti, të ardhurat e agjencive kanë qenë jashtëzakonisht shumë të ulëta, sepse lokalet ishin mbyllur e të tjera. Duke qenë se të ardhurat ishin shumë të ulëta, këto agjenci nuk mund të penalizoheshin pse marrin pagë minimale apo pse kanë punonjës, sepse janë kriteret dhe kushtet për licencim që ka nxjerrë po

Ministria e Kulturës që i detyron ata të kenë këtë punonjës, atë punonjës dhe t'i mbajnë me paga.

Pra, shprehja “përjashtimisht në shpenzimet e domosdoshme minimale” besoj se zgjidh një ngërç, i cili u shërben edhe agjencive, në rast se nuk kanë të ardhura. Thashë, janë specifike dhe prandaj është edhe shprehja “të domosdoshme dhe minimale”, duke mos lënë mundësi që të abuzojnë me këtë gjë, sepse është ministria pastaj që ka të gjitha instrumentet për t'i kontrolluar edhe në këtë pjesë që ata mund ta abuzojnë dhe vazhdon në përputhje me kushtet dhe kriteret për licencim të përcaktuar në vetë udhëzimin e Ministrisë së Kulturës. Kjo për t'u dhënë mundësinë agjencive që raste si pandemia, lufta apo edhe raste të tjera, pra, në rastet kur shpenzimet janë minimale, të mos çojnë në heqjen e licencës pikërisht për raportin e shpenzimeve dhe shpërndarjes së shpërblimeve.

Në këtë kuadër, mund të bëjmë këtë shtim, të cilin po jua lexoj edhe një herë, për të kuptuar që nuk është abuzuese ajo që po kërkoj: “përjashtimisht për shpenzimet e domosdoshme minimale të AAK-së, në përputhje me kushtet dhe kriteret e tyre për licencim, të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Kulturës”. Pra, duke e lidhur në çdo mënyrë që ju të keni kontrollin për ta parë këtë.

Ky është sugjerimi që ne kemi.

Petro Koçi – Referimi ndaj periudhave me kufizime të përgjithshme mund të qëndronte, por do të donte një formulim tjetër, jo këtë. Pra, në rastin kur ka kufizime, siç është rasti i pandemive, duhet bërë një lloj përcaktimi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëro?

Meri Kumbe - Në fakt, shqetësimi juaj ka qenë aktual me pandeminë, por në këto raste zyra e tatim-taksave ka ndërhyrë kundrejt subjekteve të licencuara dhe individëve që kanë paguar detyrimet në shtet, duke u është gjendur pranë me të ashtuquajturën “pagë lufte”, që ka siguruar pikërisht shpenzimet minimale. Në këtë rast, prekja e çdolloj fondi do të cenonte autorin. Ky ligj mbron të drejtën e autorit. Padyshim, agjencitë janë mekanizëm i ndërmjetëm, por në vetvete nuk janë qëllim i këtij ligji, qëllim është të mbrohet autori. Çdo para e shpenzuar nga buxheti, qoftë edhe për shpenzime të domosdoshme ...

Personalisht e ndaj shqetësimin me ju, kjo edhe për shkak të kushteve të jashtëzakonshme që kemi kaluar, por mendoj që në këto raste është pikërisht shteti i cili vjen me politika ndihmëse kundrejt individëve dhe subjekteve të deklaruar, sikurse edhe ka ndodhur konkretisht.

Petro Koçi - Praktikisht, punonjësit e AAK-ve i kanë marrë nga shteti pagat, sepse janë si privati, apo jo?

Borana Ajazi - Agjencitë e administrimit kolektiv në kohën e pandemisë kanë pasur vetëm shpenzimet administrative dhe nuk kanë bërë asnjë shpërndarje. Prandaj, shprehja “shpenzime të domosdoshme” është një abuzim i jashtëzakonshëm.

Në ligjin e të drejtës së autorit agjencitë e administrimit kolektiv kanë 30% shpenzime administrative të shpërndarjeve. Jo më kot është “të shpërndarjeve”. Pra, kanë përqindjen më të lartë në rajon dhe në Bashkimin Europian, sepse të gjitha vendet e tjera nuk e kalojnë 15%-in. Pra 10% - 15% është maksimalja, kurse Shqipëria e ka 30%. Pra, agjencitë mbajnë 30% të shpërndarjeve.

Nga ana tjetër, nuk mund të thuhet “shpenzime të domosdoshme”, sepse nëse janë të domosdoshme le të përcaktohet një shumë e caktuar vit pas viti. Agjencitë e administrimit kolektiv shpenzimet administrative vit pas vitit i kanë me ndryshime kolosale. Pra, nuk mund të bëhet arsyetimi që në vitin 2020 unë do të shpenzoj 150% të atyre çfarë kam mbledhur dhe në vitin 2021 do të shpenzoj 250%. Si mund të jenë të ndryshme shpenzimet e domosdoshme?

Detyrimin për të mbajtur përsipër shpenzimet e kanë vetëm agjencitë. Gjithmonë shkojmë tek i njëjti koncept. Siç e tha zëvendësministrja, ligji është për të mbrojtur të drejtën e autorit, nuk është për të mbrojtur agjencitë. Në qoftë se nuk ka kapacitet për të qenë një agjenci e administrimit kolektiv, nuk mund ta ushtrojë këtë funksion.

Prandaj, ajo që duket e thjeshtë në gjuhë, në praktikë ka jashtëzakonisht problematika. Pra, kur thuhet shpenzime të domosdoshme, nuk e dimë cilat janë shpenzimet e domosdoshme të agjencive të cilat ndryshojnë vit pas viti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk mund ta dimë nëse ndryshojnë vit pas viti dhe me përqindje të jashtëzakonshme dhe në kundërshtim me ligjin e të drejtës së autorit, që thotë 30% të shpërndarjeve jo 30% të mbledhjeve.

Petro Koçi – Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Tani të themi disa të vërteta, sepse këtu po keqinformohet. Po bëhet me qëllim apo nga mosdija, nuk e di.

Zonja zëvendësministre tha një të pavërtetë të madhe. Agjencitë nuk kanë marrë asnjë lek nga shteti dhe asnjë pagë lufte nga shteti gjatë kohës së pandemisë, jo se nuk kanë aplikuar, por sepse AAK-të janë në statusin e OJF-ve dhe OJF-të nuk kanë marrë pagë lufte nga shteti, nuk janë lejuar të aplikojnë, nuk kanë qenë pjesë e mundësisë për të marrë pagë lufte. Kështu

që, AAK-të, duke u trajtuar si OJF, ashtu është edhe ligji, nuk kanë pasur mundësi as të aplikojnë dhe as të marrin paga lufte. Informohuni nëse nuk e dini.

Pra, iku një e pavërtetë e madhe. Kjo do të thotë se gjatë situatës së pandemisë ata nuk kanë marrë asgjë. Këtë e deklaroj me përgjegjësi të plotë dhe agjencitë mund ta konfirmojnë.

Pra, ministria nuk mund të thotë se unë nuk e di çfarë bëjnë agjencitë dhe nuk i kontrolloj dot si i administrojnë. Ka një udhëzim të ministrit për kriteret dhe kushtet për licencimin e agjencive. Apo jo? A keni ju kriteret që lidhen me punësimin e personelit, me pagimin e internetit, dritave e të tjera? Këto janë kriteret minimale që unë po kërkoj, nuk po kërkoj luksin që ai mund të vendosë ...

Ai mund të dojë të hapë zyrën në çdo qytet, mund të dojë të marrë 200 njerëz personel, por po them në zbatim të atij udhëzimi që keni bërë ju, pra, të kriterëve që keni kërkuar ju, aq duhet t'i quani ju shpenzime të domosdoshme.

Në qoftë se ata vit pas viti në shpenzimet administrative vendosin gjëra luksi, janë kontrollet, auditet dhe ju mund të merrni edhe masat e nevojshme, por jo duke e bërë në këtë mënyrë pa parashikuar asgjë atje, por thjesht, kur konstatohen shkelje të kuadrit ligjor për të drejtën e autorit lidhur me shpenzimet dhe shpërndarjen e shpërblimeve. Ju në çdo moment, edhe gjatë pandemisë, sepse kemi 2 vjet e gjysmë - 3 vjet që jemi në këto kushte, ju mund t'ia hiqnit licencën një AK-je që nuk ju pëlqente, që kishit ndonjë konflikt, sepse kështu e thotë ligji. Ju do të thoshit se ia çuat lekët të gjitha me shpenzimet tuaja dhe nuk bëte shpërndarjen tek autori, sepse aq ishin të ardhurat. Pra, duhet të ketë një mekanizëm që të mos ua lërë juve në dorë të vendosni kur duhet ta heqin licencën apo jo. Kjo gjë që ne propozojmë, duke u nisur nga ajo që kërkojnë agjencitë, se ju jeni edhe interesantë kur ligjëroni, sepse thoni se duhet të bëjmë gjithçka që të shikojmë sa më shumë autorë të bëhen pjesë e agjencive; nga ana tjetër, kur ju intereson, tani në debat thoni: "Qëllimi nuk janë agjencitë. Agjencitë mund të ikin dhe mund të krijohen të tjera. Qëllimi janë vetë autorët." Pra, nga njëra anë doni të fuqizoni agjencitë dhe, nga ana tjetër, të fuqizoni e të keni sa më tepër autorë që shkojnë te agjencia.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E thashë propozimin. Ji më i vëmendshëm dhe, ndoshta, e kupton. Nuk jam interesante, se nuk vjedh. Për ju interesantë janë ata që vjedhin dhe bëjnë batuta. Tani që ta sqarojmë dhe kthehemi te pjesa ku jemi. A mendoni se është e arsyeshme, po e bëj pyetjen ndryshe, që në situata të jashtëzakonshme shteti, në këtë rast ministria, të garantojë që agjencitë nuk mbyllen vetëm se po mbajnë vetveten me paga minimale? E mendoni të arsyeshme, pra po ose jo. Nëse jo, vazhdoni dhe bjerini, bëni çfarë të doni.

Petro Koçi – Atëherë, për një moment e kapërcejmë këtë nen. Po kërkojmë se cili është përkufizimi i këtyre situatave në pandemi, sepse nuk është gjendje e jashtëzakonshme. Tri gjendje të jashtëzakonshme ka Kushtetuta. Ta gjejmë atë përkufizim; duke përjashtuar ato periudha, po themi në dy-tre muaj, që është një gjendje e përcaktuar ligjërisht jo e zakonshme.

Kalojmë te neni 13 dhe presim sa të na vijë ky lloj përcaktimi, nëse do të jetë një gjë e pranueshme. Kjo është përpjekja ime për të gjetur një zgjidhje, por, ju lutem, larg emocioneve, se ngarkojmë kot njëri-tjetrin dhe nuk gjejmë zgjidhje.

Atëherë, këtu mund të shtojmë këtë: “Përveç rasteve të fatkeqësisë natyrore dhe të gjendjes së jashtëzakonshme”, vetëm këtë mund të bëjmë. Në momentin që ka një pandemi dhe shpallet një gjendje e caktuar, për këtë periudhë nuk llogaritet kjo.

Borana Ajazi – A mundem?

Këto përkufizime janë të përcaktuara në ligje specifike, të cilat përcaktojnë rastet, kushtet, mënyrat se si do të ndodhë dhe shpërblimi i këtyre rasteve. Nuk e quajmë me vend të vendoset ky përcaktim në ligjin “Për të drejtën e autorit”, ligji është shumë i qartë: 30% të shpërndarjeve do të shkojnë për agjencinë. Agjencia, në rastin më të keq, ka mbledhur 10 lekë; këto 10 lekë do t’u shpërndahen autorëve në fillim, se edhe ata janë në gjendje fatkeqësie, nuk janë vetëm agjencitë dhe nga këta 10 lekë do të mbajnë 30%-shin e tyre. Përcaktimi ligjor që thoni se është shumë i përgjithshëm, nuk është fare kështu. Kur thuhet për të drejtën lidhur me shpenzimet, i referohet 30%-shit. Ky është përkufizimi i vetëm. Lidhur me shpërndarjen, i drejtohet 30%-shit. Pra, do të bëjnë një herë shpërndarjet për autorët, pastaj do të mbajnë shpenzimet administrative. Koncepti është shumë i thjeshtë. Ndërsa vendosja e një përkufizimi të një ligji të caktuar, ai rregullohet në mënyrë të caktuar në ligjin “Për të drejtën e autorit”.

Petro Koçi – Këtu jemi te heqja e licencës. Unë besoj se një autoritet kompetent në rastin e një gjendjeje të jashtëzakonshme e ka edhe vetë parasysh situatën. Jemi të detyruar të respektojmë situatat. Nuk ndryshon përqindja. Ky nen nuk ndryshon përqindjen. Ky është neni që ka lidhje me heqjen e licencës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, po!

Në fakt, ai ndryshim që kërkohet, që propozohet, ka të bëjë me ndryshimin e përqindjes. Është tjetër gjë.

Ina Zhupa – Jo, nuk ka të bëjë fare me atë. Është shumë e thjeshtë, por bëjmë sikur nuk e kuptojmë. Gjatë pandemisë një agjenci X merr të ardhura një milion lekë të vjetër gjithsej. Bëjmë një ushtrim matematikor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bën mbledhjen. Tani, sipas kriterëve që ka agjencia, sipas ligjit, duhet të ketë një numër punonjësish, katër punonjës, një i zëmë ne, por duhet të ketë punonjës, duhet të ketë një zyrë e të tjera. Që agjencia të mbajë veten, këto i ka detyrime mujore, pra të paguajë rrogat, qiranë e zyrës. Nga këto detyrime, që i lindin nga udhëzimi i ministrit, që duhet të ketë dhe atë, pesë punonjës, tre-katër sa janë, i shkojnë shpenzimet 1 milion 100 mijë lekë. Ajo 1 milion ka mbledhur, ose po themi shkon 1 milion. Me një milion lekë të vjetër, 100 mijë lekë të rinj, sepse është vit pandemik, çfarë ndodh? Ka dy lloje detyrimesh, i vijnë nga shteti, pra të paguajë punonjësit, që duhet t'i mbajë në punë, të paguajë zyrën, si dhe detyrimi tjetër, që i vjen po nga shteti, që 30% të kësaj shume t'ua shpërndajë me detyrim autorëve. Si i bëhet në këtë rast, kur të ardhurat janë 1 milion dhe t'i nuk mbulon dot as shpenzimet që i ke përsëri detyrim nga ligji?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju keni një problem në retorikë. Pra, doni të fuqizoni agjencitë që të mbron autorët dhe jeni që të shkatërrohen agjencitë dhe nuk ka gjë për autorët. Hajde merre vesh se si është logjika! Tani, kur jemi në situatë të veçantë, unë e kuptoj që mund të ndërhyjë ministria, por mund të ndërhyjë duke u dhënë autorëve para, duke mos e cenuar agjencinë në këtë rast që është OJF dhe nuk merr dot asgjë nga shteti, por autorët mund të marrin drejtpërdrejt nga shteti. Bëhet fjalë për raste të jashtëzakonshme dhe nuk bëhet fjalë për një situatë normale, sepse, duke shfrytëzuar këto situata, ne mund të vijmë në rastin kur bëhet edhe ai seleksionim i agjencive. Ju mbyllni ato agjenci, që i shikoni si me prirje të djathta dhe mbani ato agjenci...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, sepse tani është rasti. Ky është një shqetësim që na vjen nga...

Petro Koçi – Faleminderit!

Besoje se janë ezauruar të gjitha argumentet. Nuk ka argumente plus.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, një minutë! E kam unë fjalën! A ka mundësi t'i lini replikat, zonja Zhupa?! Edhe një herë nuk ka argumente plus. Unë e kuptoj merakun, nuk është se e quaj jo të natyrshëm, por ligji është për të drejtën e autorit dhe jo për të drejtat e agjencive.

E dyta, bëhet fjalë për kushtet, në të cilat hiqet një licencë, nuk është neni që ndan përqindjet në kushte normale apo jonormale. Prandaj nuk kemi çfarë të diskutojmë më tej. Kot të fusim emocione politike në diskutime, sepse nuk ndreqim, por vetëm prishim punë. Unë isha dashamirës i kësaj ideje, por e shikoj që është një gjë, e cila nuk rregullohet dot te ky nen.

Kush është dakord me nenin 12, sipas projektit? Kundër? 3 vota. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Neni 177 shfuqizohet”.

Borana Ajazi – Neni që ka të bëjë me kodifikimet, me një procedurë të veçantë të shqyrtimit të rasteve të piraterisë. Pra, nëse konstatohet që për një vepër pa autor kemi rast piraterie, do të përdorim kodifikime të caktuara për secilin nga këto produkte. Ky nen nuk gjen zbatim, sepse mënyra për ndjekjen e piraterisë ka ndryshuar. Në ligji dhe në Kodin Penal janë të përcaktuara masat administrative dhe masat penale lidhur me piraterinë e të drejtës së autorit. Pra, është një nen që nuk gjen zbatim. Mënyra për ta vënë në zbatim është shumë e shtrenjtë dhe e papërshtatshme për territorin e Republikës së Shqipërisë, për këtë arsye shfuqizohet.

Petro Koçi – Ka qenë nen jorealit. Kush është dakord me nenin 13, që të shfuqizohet neni 177 i ligjit në fuqi? Faleminderit! Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Në pikën 5 të nenit 187, pas fjalëve “pika 8 e nenit 32” shtojmë fjalët “pika 7 e nenit 16/1”.

Borana Ajazi – Teknikë legislative.

Petro Koçi – Kush është dakord? Faleminderit! Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15, i cili bën fjalë për gjobat në bazë të shkeljeve, kundërvajtjeve administrative.

Borana Ajazi – Po të vini re, te neni 15 të gjitha pikat e paraqitura janë pikat në rastet e pezullimit të licencës së agjencive të administrimit kolektiv. Duke vlerësuar që fillimi i procedurës së pezullimit të menjëhershme për licencën do të ishte me pasojë për mbajtësit e të drejtave, është menduar që në rast mosdhënies së informacionit, të mosparaqitjes pranë ministrisë së Kulturës nga agjencitë e informacionit kur duhet dhe disa kushte të tjera, të aplikohet një masë administrative.

Petro Koçi – Ky është ndryshimi që bëme ne në fillim. Pra, të mos kalohet te pezullimi.

Borana Ajazi – Po, se pezullimi është një masë shumë e rëndë.

Petro Koçi – Kush është dakord me nenin 15? Faleminderit! Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Ky nen është teknikë legislative.

Kush është dakord me nenin 16, sipas përmbajtjes në projektligj? Faleminderit! Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Nxjerrja e akteve nënligjore”. Kush është dakord? Faleminderit!

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, titulli të rregullohet, gjithashtu edhe rregullimin që thamë më parë.

Kush është dakord? Faleminderit! Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Faleminderit! Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Takohemi në mbledhjen tjetër.

MBYLLET MBLEDHJA